



VENDIM

Nr. 53, Datë 06.04.2017

MBI

**ÇMIMIN E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI UNIVERSAL PËR KATEGORINË OBJEKTE
KULTI/BASHKËSI FETARE**

Në mbështetje të neneve 16; 85 pika 1 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Rekomandimit të Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, përcjellë në ERE me anë të shkresës Nr. 3791, datë 16.12.2016 si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s“, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.04.2017, pasi shqyrtoi, relacionin e Drejtorive Teknike,

Konstatoi se:

- Nëpërmjet Shkresës nr 390, prot datë 29.09.2016, Komiteti Shtetëror për Kultet ka parashtruar kërkesën mbi mundësinë e ndryshimit të tarifës së energjisë elektrike për bashkësitë fetare.
- Kjo kërkesë ka gjetur mbështetjen e Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese nëpërmjet shkresës nr. 3791 prot, datë 16.12.2016.
- Bordi i ERE-s, me Vendimin Nr. 193, datë 22.12.2016, vendosi: “Fillimin e procedurave për rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi Universal për kategorinë Klient - Objekte Kulti/Bashkësi Fetare”.
- Konferenca Ispeshkvnore e Shqipërisë, me anë të shkresë Nr. 8/17, datë 23.02.2017, parashtrroi një relacion për të pasqyruar një kuadër të përgjithshëm të veprimtarive të strukturave të Kishës Katolike.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Klientët - Objekte Kulti/Bashkësi Fetare të klasifikuar të tillë sipas legjislacionit në fuqi, të faturohen me çmimin 9.5 Lekë për kWh nga data 1 Prill 2017 deri në 31.12.2017.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe Komitetin Shtetëror për Kultet për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.